



VENDIM

Nr. 126, Datë 29.07.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURES PER MIRATIMIN E MARRËVESHJES
SË SHERBIMIT TE TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE
NDERMJET OST SH.A. DHE FURNIZUESIT.**

Në mbështetje të nenit 16, të Seksionit IV të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 29.07.2016 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE për miratimin e Marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për miratimin e Marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe Furnizuesit;
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.